



2.00 - LUANI I JUDËS ON LINE – Prezantim

(2.00 - LION OF JUDAH ON LINE - Introduction)

PREZANTIM – Shërbesa e Trajnimit & Pajisjes

(Shkrimet nga ALBB)

Ngritja, Trajnimi dhe Pajisja e një Brezi të Ri Besimtarësh!

Dhe Ai i dha disa si apostuj; disa profetë; disa ungjilltarë; disa pastorë dhe mësues; për përsosjen e shenjtoreve, për punën e shërbesës, për ndërtimin e trupit të Krishtit; (Efesianët 4:11-12)

Ne jetojmë në një periudhë kohe sa sfiduese po aq edhe emocionuese. Shumë e më shumë po përmbushen profeci biblike për fundin përpara syve tanë. Ardhja e dytë e Jezus Krishtit është gjithnjë e më shumë afër dhe Ai po vjen për një nuse të lavdishme dhe triumfuese, pa njolla apo rrudha.

Perëndia dëshiron një marrëdhënie të thelle intime me bijtë dhe bijat e Tij. Është prej vullnetit të Tij që ata ta njohin Atë dhe të kenë baza të thella në dashurimë e Tij, në mënyrë që ujërat e Tij të gjallë të kalojnë përmes tyre nëpër botë. Si fillim, Ai do t'u shërbejë atyre, dhe përmes tyre, njerëzve të kësaj bote.

Perëndia është duke bërë diçka të re dhe është e rëndësishme në këtë kohë që të besojmë tek Ai dhe t'i pranojmë ndryshimet e Tij, edhe nëse shumë nga ato që hasim është e panjohur dhe e çuditshme për ne. Nëse do të qëndrojmë në Perëndinë, do të qëndrojmë në fuqi dhe do të forcohem si të Krishterë dhe të përgatitemi për atë që na pret në të ardhmen.

Është misioni dhe zemra e "Löwe von Judah Ministries International" (Shërb. Ndërk. Luani i Judës) që përmes shërbesës së pesëfishtë të ndërtojë një brez "të ri" besimtarësh që do të jetojnë në marrëdhënie të ngushtë me Perëndinë. Një brez bijsh dhe bijash të Perëndisë që mund të dëgjojnë dhe të pranojnë nga Perëndia. Ata do të trajnohen, pajisen, inkurajohen në dhuntitë dhe thirrjet e tyre dhe do t'u tregohet si ta njohin autoritetin e dhënë nga Perëndia dhe si ta ushtrojnë atë. Një brez besimtarësh që do të jetojnë një krishtërim të vërtetë, do të jetojnë të mbinatyreshmen natyrshëm dhe të gatshëm për të bërë vullnetin e Perëndisë.

Në kurset e suksesshëm, pjesëmarrësit do të konsolidohen në bazat e besimit të Krishterë dhe do të udhëhiqen drejt një stili jetese autentik të mbinatyreshëm drejt plotësisë që Perëndia ka siguruar për ne. Jezusi tha që ne do të bëjmë të njëjtat vepra që Ai ka bërë, madje edhe më shumë.

Është koha për "Kishën triumfuese" të ngrihet në lavdi; nusja e Tij e dashur, për të cilën ai po pret.

Rev. Gary Stevens
Lion of Judah Ministries International



2.00 - LUANI I JUDËS ON LINE – Prezantim

(2.00 - LION OF JUDAH ON LINE - Introduction)

PREZANTIM – Kurset & Temat

1. Kjo shërbesë “Trajnimi & Pajisja” është bërë për çdo “besimtar” edhe nëse ata janë të sapo “rilindur” apo janë “rilindur” shumë vite më parë. Rritja frymërore e atij personi përcaktohet nga vetë ai, se sa shpejt apo ngadalë do të përparojë në temat dhe kurset. Personi mund ta përsëritë një temë sa herë ta shohë të nevojshme, përpara se të kalojë tek tema tjetër.
2. Kurset dhe temat janë projektuar dhe vendosur në një rregull që ta marrë një besimtar nga të qënit i “rilindur”, drejt tek pjekuria frymërore për të bërë punën e shërbesës dhe të ndërtojë “Trupin e Krishtit” dhe të zgjerojë “Mbretërinë e Perëndisë” këtu në tokë.
3. Kurset janë të lira e falas dhe mund të shkarkohen në faqen tonë të internetit www.lowevonjudah.org së bashku me shënimet korresponduese në formatin PDF për çdo temë, të cilat mund të printohen në çfarëdo lloj sasive. Videot janë në formate të ndryshme (Mobile SD / SD / HD) dhe mund të përdoren direkt ose të ruhen për një kohë tjetër për përdorim personal ose punë në grupe. Thjesht klikoni në ikonën e zezë me luanin e bardhë, “LION OF JUDAH ON LINE” e cila të drejton në hapin tjetër për ta parë ose në procesin e shkarkimit.
4. Këto kurse të ndryshme kanë për qëllim t’ju japin një themel bazë mbi të cilin ju do të ndërtoheni më tej, përmes studimit personal, dhe zhvillojnë pjekurinë frymërore dhe rritjen në shërbesë.
5. Shërbesa “Trajnim & Pajisje” është vendosur edhe në anglisht, meqënëse kjo gjuhë është gjerësisht e përdorshme në shume shtete të botës, madje edhe si gjuhë e dytë.
6. Mënyra më e mirë për ta kuptuar sistemin e përdorur përgjatë “Trajnim & Pajisje”, është të imagjinoni një shkallë. Çdo temë përfaqëson një shkallë të vetme e cila të çon drejt katit apo nivelit tjetër. Çdo “nivel” do t’ju drejtojë në një “pozicion” tjetër më të madh të rritjes dhe pjekurisë frymërore për “besimtarin”. Çdo temë është projektuar për të ndërtuar mbi temën tjetër.
7. Nëse vendi juaj ku do të përdoren këto kurse nuk e ka anglishten si gjuhë të parë, rekomandohet që të gjeni një person i cili e kupton dhe e flet në mënyrë të rrjedhshme gjuhën angleze. Në këtë mënyrë, kurset mund të përdoren në çdo vend të botës.
8. Shërbesa Ndërkombëtare Luani i Judës (Löwe von Judah Min. Int.) nuk merr përsipër përgjegjësitë për ndonjë keqkuptim që mund të ndodhë gjatë procesit të përkthimit. Përgjegjësia është e përkthyesit, i cili mund t’i rikthehet shënimeve origjinale në anglisht, për të pasur një kuptim më të saktë për atë që thuhet në shënimet përkatëse.
9. Ajo që unë ndaj, mësoj dhe shpjegoj, është nga përvoja ime personale e rritjes frymërore, përvoja praktike e dorës së parë në jetë dhe shërbesë, studime personale dhe zbulesë nga “Fjala e Perëndisë” që nga koha kur unë “rilinda” në vitin 1989. Disa nga gjërat që unë do të mësoj ose shpjegoj, mund të sfidojnë ato që ju dini tashmë, që besoni apo që keni mësuar gjatë viteve. Do t’ju lutesha të mos e kundërshtoni këtë informacion që në fillim, por shkoni tek Perëndia dhe Fjala e Tij, dhe kërkojini më shumë kuptim dhe konfirmim, më pas, nëse nuk jeni i kënaqur me këtë informacion, mund ta hiqni.
10. Gjithashtu, është e rëndësishme të kuptohet që unë nuk i di të gjitha gjërat që duhet të dihen rreth Perëndisë dhe Fjalës së Tij – asnjë shërbëtor i Ungjillit nuk i di, por ne mund të mbështetemi edhe tek shërbesat e tjera që kanë më shumë kuptim në fusha të ndryshme të Fjalës së Perëndisë dhe përvojë në shërbesë.
11. Fjala e Perëndisë thotë që duhet të provojmë çdo gjë që marrim dhe kjo mund të bëhet duke përdorur pasazhe që janë brenda “Fjalës së Perëndisë”, si edhe duke marrë nga Perëndia një “dëshmi ose konfirmim të brendshëm” në njeriun tonë frymëror. “Feja dhe traditat” e njeriut do të shtrembërojnë kuptimin e TRUPIT TË KRISHTIT (KISHËS) MBARËBOTËROR!

JEZUSI ËSHTË ZOT!